

URDHËR
Nr. 119, datë 5.2.2025

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME
PATOGENITET TË LARTË TË SHPENDËVE TË SHFAQUR NË SHETETIN E
BULLGARISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:
 - a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
 - b) zogjve 24-orësh;
 - c) shpendë dekorativë;
 - ç) materialit biologjik të shpendëve;
 - d) vezët e shpendëve;
 - dh) mishi i shpendëve i patrajtuar termikisht;
 - e) nënproduktet e shpendëve të patrajtuara termikisht.
- Nga shteti i Bullgarisë, sipas tabelës së mëposhtme:

<i>Ndarja administrative e nivelit 1</i>	<i>*Ndarja administrative e nivelit 2</i>
Yambol*	Tundzha*
Plovdiv	Asenovgrad*

Shënim. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Certifikata veterinarë të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.
 3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjtë 24-orësh, shpendë dekorativë, materialit biologjik, vezët e shpendëve, mishi i shpendëve i patrajtuar termikisht dhe nënproduktet e shpendëve të patrajtuara termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.
 4. Urdhri nr. 1022, datë 26.11.2024, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve të shfaqur në shtetin e Bullgarisë”, shfuqizohet.
 5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZËVENDËSMINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Arian Jaupllari